



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Granit (Hakif) Berishës.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale, nr. 00931-0, Zona kadastrale Matëçan, e evidentuar në Certifikatën e njësisë kadastrale, nr. P-71914050-00931-0, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale, sipërfaqja prej 2521 m², parcela kadastrale nr. 329-0, e evidentuar në Certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914045-00329-0, sipërfaqja prej 1332m², parcela kadastrale nr. 348-0, e evidentuar në Certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914045-00348-0, sipërfaqja prej 1022 m², parcela kadastrale nr. 349-0, e evidentuar në Certifikatën e njësisë kadastrale, P- 71914045-00349-0, Zona kadastrale, Llukar, pronë e paluajtshme në pronësi të Granit (Hakif) Berishës.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit zhvillimor urban, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 035-181427, dt, 24.09.2013, me destinim përfshihet zonë për gjelbërim dhe është marrë për deponi.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Granit (Hakif) Berisha, me kërkesën nr. 13-463/03-14131/21, ka kërkuar këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale, nr. 931-0, me sipërfaqe prej m², Zona kadastrale, Matiçan në pronësi pronë shoqërore, KK Prishtinë dhe parcelat kadastrale nr. 329-0, me sipërfaqe prej 2521m², 348-0, me sipërfaqe prej 1332m², 349-0, me sipërfaqe prej 1022m², Zona kadastrale, Llukar, Prishtinë, në pronësi të Granit (Hakif) Berishës.

Propozimi për inicimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarin e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit zhvillimor urban, të miratuar në bazë të Vendimit të KK Prishtinë, 01 nr. 035-181427, dt. 24.09.2013, me destinim përfshihet zonë për gjelbërim dhe është marrë për deponi.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private është duke u zhvilluar në bazë të nenit 24 të Ligjit nr.06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, pasi Komuna nuk ka pronë të veten për implementimin e projekteve të lartcekura.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruara në pjesën hyrëse të këtij Propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112294/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

